

KRITERET E TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIES

Forcimi i shoqërisë civile Rome si organizata
monitoruese transparente
dhe të pavarura



European Roma Grassroots Organisations Network

KRITERET E TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIES

Forcimi i shoqërisë civile Rome si organizata
monitoruese transparente
dhe të pavarura



E drejta e autorit © Rrjeti ERGO

PRiprodhimi i materialit në këtë botim është i autorizuar vetëm për Qëllime
arsimore jo-komerciale, me kusht që të citohet burimi.

www.ergonetwork.org

Rue d'Edimbourg 26

1050 Brussels

Qershor 2018

KRITERET E TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIES

Nevoja për transparencë në funksionimin e brendshëm të shoqatave nuk është përcaktuar specifikisht në traktatet ndërkombëtare dhe rajonale në bazë të së drejtës së shoqatave që të jenë të lira nga ndërhyrja e shtetit në punët e tyre të brendshme. Megjithatë, hapja dhe transparenca janë thelbësore për krijimin e llogaridhënies dhe besimit të publikut (OSBE/ODIHR, 2015).

Kriteret e transparencës shoqërohen me materiale trajnimi që mbështesin organizatat për të zbatuar kriteret në strukturat e tyre dhe punën e tyre të përditshme. Ju mund të porositni versionin offline të 'Transparency Board Game' nga sekretariati i Rrjetit ERGO dhe të aksesoni mjetin e trajnimit online në adresën

www.ergonetwork.org/transparency

1) Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, Komisioni Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias), Udhëzimet e përbashkëta për Lirinë e Shoqatave, 2015, f.62.

HYRJE

Rrjeti ERGO së bashku me organizatat e tij anëtare - Qendrën për Kërkim dhe Advokaci (Sllovaki), Roma Active Albania (Shqipëri), Slovo 21 (Republika Çeke), Fondacioni Autonomia (Hungari), OTHARIN (Bosnje dhe Hercegovinë), RROMA (Maqedoni), Mladi Romi (Mali i Zi) dhe Diskriminimi Zero (Turqi) - përgatitën një sërë kriteresh transparencës dhe llogaridhënies për organizatat komunitare, **me qëllim forcimin e organizatave të shoqërisë civile**. Përdorimi i kriterëve do të japë më shumë legjitimitet, mundësi më të mira për mbledhjen e fondeve dhe më shumë besim nga niveli komunitar dhe institucionet dhe përfundimisht do të përforcojë fuqinë e organizatave të shoqërisë civile. Të qenit transparent dhe i përgjegjshëm janë parakushte të rëndësishme për efektivitetin e shoqërisë civile që merret seriozisht nga homologët e saj institucionale dhe partnerët e tjerë.

Gjithashtu, anëtarët e Rrjetit ERGO ranë dakord për bashkimin e përpjekjeve të tyre dhe grumbullimin e ekspertizës së tyre të plotë **për të aftësuar romët dhe shoqërinë civile pro-rome në vendet e tyre në zbatimin e kriterëve të transparencës**. Organizatat që i përmbushin këto kritere do të përdorin një etiketë të transparencës për të sjellë vëmendje cilësinë e tyre në qeverisje, menaxhim dhe performancë.

Profesionalizimi i shoqërisë civile rome në lidhje me transparencën dhe llogaridhënien është një proces që synon përmbushjen e qëllimeve specifike si në vijim:

- ✓ Të jetë model për organizatat e tjera në fushën e transparencës dhe llogaridhënies në promovimin e vlerave pozitive dhe për të mbështetur të tjerët me ekspertizë

- ✓ Të përmirësohet efektiviteti i OSHC-ve nëpërmjet funksionimit të strukturave të qarta
- ✓ Të rritet ndikimi i punës së OSHC-ve, duke siguruar ndryshim pozitiv dhe duke dhënë rezultate pozitive afatgjata
- ✓ Të forcohet kapaciteti për trajtimin e çështjeve të të drejtave të romëve;
- ✓ Të bëhen partnerë të barabartë me institucionet
- ✓ Të krijojnë një lidhje më të mirë me nivelin bazë/komunitar
- ✓ Të garantojnë qëndrueshmëri më të madhe të OSHC-ve
- ✓ Të mbështesin mbledhjen e fondeve
- ✓ Të krijohen kushte për krahasueshmërinë e OSHC-ve
- ✓ Të garantojnë siguri, përkatësisht duke respektuar legjislacionin kombëtar.

Së fundi, përmbushja e kriterëve të transparencës do të thotë jo vetëm që të jenë në gjendje të tregojnë se shoqëria civile romë dhe pro-romë i merr ato shumë seriozisht, por gjithashtu ka të drejtë të **kërkojë të njëjtën gjë nga palët e tjera të interesit.**

Ne jemi të vetëdijshëm për sfidat me të cilat organizatat bazë/komunitare mund të përballen në zbatimin e kriterëve të tilla si kompleksitetet e politikës lokale apo mungesës së burimeve njerëzore. Kjo grup kriteresh përshkruan mënyrat sesi organizatat e shoqërisë civile duhet të qeverisen dhe menaxhohen. Ai fokusohet në kriteret e zbatueshme në fushat e

1) **Qeverisjes,**

2) **Menaxhimit financiar** dhe

3) **Performancës.**

VLERAT BAZË

Një organizatë e shoqërisë civile duhet të **pranojë që të gjithë njerëzit kanë lindur të lirë dhe të barabartë në dinjitet**. Duhet të jetë e ndjeshme ndaj vlerave morale, feve, zakoneve, traditave dhe kulturës së komuniteteve që i shërben. Një OSHC **nuk duhet të shkelë të drejtat e njeriut**. Duhet të jetë e ndershme dhe e sinqertë në marrëdhëniet e saj me njerëzit të cilët ata synojnë të fuqizojnë, donatorët, stafin, anëtarët dhe partnerët, institucionet qeveritare dhe publikun në përgjithësi; nuk duhet të ketë një axhendë të fshehtë, dhe **duhet të respektojë ligjin**. Një OSHC duhet të jetë e **përgjegjshme** për stafin, partnerët dhe zonën zgjedhore, por edhe për publikun në përgjithësi.

Edhe OSHC-të më të sinqerta mund të përfitojnë nga kriteret e transparencës për shkak të standardeve të tyre të pranueshme të identifikuara sistematikisht dhe praktikave etike. Ato ofrojnë një kontroll etik, duke shërbyer gjithashtu si një deklaratë dhe dëshmi se rëndësia e **ruajtjes së standardeve të larta** merret seriozisht. Kriteret e tilla gjithashtu mund të ndihmojnë palët e interesuara në identifikimin dhe shmangien e organizatave të papërgjegjshme.

Progresi i qëndrueshëm, paqja dhe drejtësia kërkojnë që të gjitha organizatat **të kontribuojnë për të mirën e përbashkët**. Kështu, një OSHC duhet të balancojë vetë-zhvillimin dhe shërbimin ndaj të tjerëve. Thelbësore për vetë karakterin e secilës OSHC është se ato **nuk janë fitimprurëse, joqeveritare dhe politikisht të pavarura**.

KRITERET E QEVERISJES

Një strukturë qeverisëse efektive dhe një organ qeverisës i fortë, aktiv dhe i angazhuar janë thelbësore për aftësinë e një organizate për të arritur misionin dhe objektivat e saj.

Struktura e qeverisjes duhet të pasqyrojë vlerat dhe misionin themelor të organizatës. Organi qeverisës mban përgjegjësinë përfundimtare për të gjitha aktivitetet dhe burimet e tij. Kjo përfshin krijimin e drejtimit të organizatës, duke filluar me deklaratën e misionit. Organi qeverisës gjithashtu përcakton aktivitetet e organizatës dhe monitoron pajtueshmërinë e tyre me misionin. Ai ushtron përgjegjësi për marrjen dhe përdorimin në mënyrën e duhur të burimeve njerëzore dhe financiare për të kryer misionin e organizatës dhe për të mbështetur organizatën, dhe mbikëqyr kërkesat ligjore. Për të përmbushur kriteret e transparencës në lidhje me qeverisjen, organizatat duhet të krijojnë kushte për të realizuar sa më poshtë:

Strukturë të qartë të organeve vendimmarrëse me përgjegjësi të përcaktuara

Rregulla të qarta procedurash për organet vendimmarrëse

Zgjedhje të rregullta të organit drejtues nga asambleja e përgjithshme (nëse nuk ekzistojnë struktura të tjera zyrtare organizative, p.sh. fondacione)

Strukturat qeverisëse të çliuara nga tokenizmi, nepotizmi dhe konflikti i interesit.

Pjesëmarrja e rëndësishme e grupit të synuar në vendimmarrje(të paktën një anëtar i grupit të synuar duhet të përfaqësohet në organin drejtues).

Pjesëmarrje e barabartë e grave dhe përfaqësim i të rinjve, si dhe ekuilibër moshor në organe vendimmarrëse; përfaqësim gjeografik, nëse është e zbatueshme.

Procedurë për emërimin e individëve për të vepruar në organin drejtues të njohur për anëtarët dhe palët e tjera përkatëse.

Deklaratë e qartë misioni e miratuar nga organi qeverisës për të përcaktuar arsyet pse OSHC-ja ekziston dhe çfarë dëshiron të arrijë, rishikuar në mënyrë periodike.

Qeverisja demokratike (jo-autoritare, duke marrë opinionin e bashkëpunëtorëve në mënyrë të barabartë, sistemin e votimit të brendshëm etj.)

Konsultimi /lidershipi i hapur (besimi dhe përlësia që të heqin dorë nga nevoja për të qenë në kontroll duke frymëzuar angazhimin e njerëzve për të arritur qëllimet)

Plani strategjik shumëvjeçar ose vjetor strategjik i miratuar nga anëtarësia, me qëllim përmbushjen e misionit të organizatës dhe një sistem monitorimi për të kontrolluar përmbushjen e tij

Kodi i sjelljes dhe politika e mbrojtjes së fëmijëve (të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e personelit /vullnetarët).

Procedurat për kryerjen e roleve të personelit.

KRITERET E MENAXHIMIT FINANCIAR

Organizatat e shoqërisë civile duhet të kenë procedura të duhura financiare për të siguruar të gjithë partnerët dhe publikun e gjerë se investimi në organizatë është i sigurt. Organizatat duhet të përdorin procedura të brendshme financiare, të mbajnë të dhënat financiare me kujdes dhe t'i vënë pasqyrat financiare në dispozicion të publikut. Ata gjithashtu duhet të kryejnë rishikimin e të dhënave të tyre financiare periodikisht. Për të përmbushur kriteret e transparencës në lidhje me menaxhimin financiar, organizatat duhet të krijojnë kushte për realizimin e sa më poshtë:

Shfrytëzimi i burimeve të saj në një mënyrë efektive dhe efikase drejt përmbushjes së qëllimit të saj të deklaruar.

Trajtimi i burimeve me përgjegjësi për të arritur qëllimet e organizatës dhe për t'i shërbyer të mirës publike

Duke frenuar përdorimin e burimeve të paligjshme, burimeve nga shoqëri që njihen si padrejta, nga shoqëri që përdorin punën e fëmijëve dhe të ngjashme.

Frenimi nga keqpërdorimi i parave publike (të gjitha pasuritë publike duhet të trajtohen si trust publik); dhe duke iu kundërvënë korrupsionit, mitmarrjes dhe parregullsive të tjera

Mos-shpenzimi i më shumë se 35% për punë të brendshme (duke nënkuptuar shpenzimin e të paktën 65% të shpenzimeve të saj totale në aktivitetet e programit, dhe në mënyrë ideale më

Zbulimi i burimeve të financimit (donatorët e organizatave botuese, zbulimi i shumave të shpenzuara për lobim ndaj autoriteteve publike (nëse është e zbatueshme).

Njoftimi i raporteve financiare vjetore

Respektimi i legjislacionit kombëtar dhe afateve kohore (mbajtja e llogarive deklarata fiskale, kërkesat kontraktuale për personelin dhe vullnetarët etj.)

Vendimet financiare të kryetarit ose të nëpunësit të thesarit nuk merren në mënyrë të pavarur nga organi drejtues.

Rregulloret e brendshme për pagesat, p.sh. sistemi nënshkrues për pagesat dhe politikat e tjera financiare dhe administrative dhe stafi i paraqitur për to.

Sistemi i kontrollit të librave nga bordi i drejtorëve dhe / ose miratimi nga asambleja e përgjithshme.

Auditimet e jashtme financiare vjetore, nëse është e mundur. Libra të përditësuar rregullisht, në mënyrë që situata financiare të mund të jepet në kohë.

KRITERET E PERFORMANCËS

Personel i përkushtuar dhe përgjegjës dhe vullnetarët janë mjaft të rëndësishëm për suksesin e një OSHC-je. Duhet të kërkojë personel të

kualifikuar, t'u ofrojë atyre trajnim dhe mbikëqyrje të duhur, t'i trajtojë me drejtësi dhe barazi, dhe t'u sigurojë rrugët për rritjen dhe zhvillimin individual. Nga ana tjetër, OSHC-ja duhet të presë që punonjësit dhe vullnetarët të ruajnë standardet më të larta të sjelljes profesionale, të përdorin informacionin dhe burimet me përgjegjësi dhe të shmangin konfliktet e interesit. Të përmbushen kriteret e transparencës në lidhje me performancën, organizatat duhet të krijojnë kushte për realizimin e sa më poshtë:

Aktivitete të pajtueshme me misionin e organizatës.

Shqyrtime periodike themelore të aktiviteteve për të përcaktuar rëndësinë e tyre ndaj misionit, efikasitetin dhe efektivitetin e tyre, vlerën e programeve.

Trajtimi i shkaqeve kryesore të çështjeve me të cilat organizata po punon dhe advokon për ndryshim rrënjësor.

Ndarja e njohurive dhe shkëmbimi me palët e interesit.

Marrja e vendimeve të përgjegjshme ndaj reagimeve nga njerëzit e prekur nga puna e organizatës, partnerët, vullnetarët dhe personeli.

Kërkon rregullisht reagime/komente mbi aktivitetet e tij nga të gjithë partnerët.

Komunikimi i vizionit, misionit dhe qëllimeve strategjike nga jashtë dhe brenda vendit.

Vizibiliteti i aktiviteteve dhe rezultateve (nëpërmjet faqes së internetit, buletinit, fletëpalosjeve etj).

Pjesëmarrje kuptimplotë e grupit të synuar në të gjitha nivelet (punë e drejtuar nga njerëzit dhe partneritet i respektueshëm).

Sigurimi i një kanali komunikimi për publikun për të kryer kërkime.

Investim në personel dhe vullnetarë për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë dhe për të arritur qëllimet e organizatës, duke ofruar trajnime, duke siguruar një proces cilësor të nxitjes së personelit të ri dhe mbledhjeve dhe vlerësimeve të rregullta të ekipit.

Respektimi i ekspertizës duke zgjedhur ekspertë ose organizata të ekspertëve, bazuar në njohuritë dhe përvojën e tyre, jo në bazë të miqësisë apo lidhjeve familjare.

Mbajtja e marrëdhënieve etike dhe bashkëpunuese me OSHC dhe partnerët e tjerë, kur është e mundur dhe e përshtatshme për të mirën publike në shkallë më të gjerë.

Kriteret e Transparencës u krijuan nga Rrjeti ERGO me mbështetjen e Fondit Ndërkombëtar të Vishegradit nën "Iniciativën e Përbashkët për Fuqizimin e Shoqërisë Civile të Komunitetit Rom në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi" dhe

programet "Përfshirja e Komunitetit Rom në Europën Sociale" së bashku me organizatat partnere në vijim:

Slovo21 - Republika Çeke

Qendra e Kërkimit dhe Advokacisë për Komunitetin Rom - Sllovaki

Autonomia Foundation - Hungari

Roma Active Albania

OTAHARIN - Bosnja dhe Hercegovina

RROMA – Maqedoni

Mladi Romi - Mali i Zi

Diskriminimi Zero - Turqi



JOINT INITIATIVE to Empower Roma Civil Society in the Western Balkans & Turkey

Ky botim ka marrë mbështetje financiare nga Programi i Bashkimit Evropian për Punësim dhe Inovacionin Social "EaSI" (2014-2020). Për informacione të mëtejshme, ju lutem konsultoni me faqen: <http://ec.europa.eu/social/easi>.



Botimi është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian nëpërmjet Programit IPA të Shoqërisë Civile, në kuadër të projektit “Nismë e Përbashkët për të Fuqizuar Shoqërinë Civile Rome në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi”



Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e rrjetit ERGO dhe Roma Active Albania, dhe nuk mund të konsiderohet në asnjë mënyrë se pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian. Komisioni nuk është përgjegjës për ndonjë përdorim që mund të bëhet për informacionin që përmban.

<https://www.visegradfund.org/>.